



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 16.07.2019

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10242, DATË 25.2.2010
“PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E
KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI””**

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 16.07.2019 mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri””, nismë e një grupi deputetësh.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten znj.Klotilda Bushka.

Në mbledhjen e komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit, ishin të pranishëm: deputetët propozues, drejtori i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, z. Agron Tufa, përfaqësuesit e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga një grup deputetësh, sipas përcaktimeve të neneve 78, 81, pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar nga deputetët synon saktësimin e periudhës së rregjimit komunist në Shqipëri, në funksion të qëllimit dhe objektit të këtij ligji si dhe përcaktimin e një kriteri shtesë që duhet të plotësojnë anëtarët e Bordit dhe punonjësit e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri (në vijim “Institut”), për t’u pajisur me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, për plotësimin e kushteve për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

Pikënisje për propozimin e këtij projektligji nga deputetët nismëtarë u bë rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2018”. Kuvendi pasi vlerësoi veprimtarinë vjetore të Institutit për vitin 2018, miratoi disa rekomandime për vitin 2019.

Një nga rekomandimet e rezolutës së Kuvendit për Institutin është propozimi i ndryshimeve të duhura ligjore, të cilat sjellin përmirësimin e punës në arkivin e Institutit, në përcaktimin e detyrimit ligjor për pajisjen me “certifikatë sigurie” për punonjësit që punojnë me dokumentet arkivore brenda dhe jashtë tij, me përcaktimin e qartë ligjor të “periudhës së sistemit komunist” në Shqipëri, si dhe me specifikimet që lidhen me kualifikimet shkencore të domosdoshme (tituj dhe grada shkencore), që duhet të kenë punonjësit e Institutit që merren me studime dhe botime.

Nisma ligjore u prezantua në mbledhjen e komisionit nga z. Adnor Shameti si një nga nismëtarët e këtij projektligji.

Z. Shameti argumentoi se objekti dhe qëllimi i këtij ligji është i lidhur me krimet dhe pasojat e komunizmit në Shqipëri pas çlirimit të vendit dhe jo me të gjithë periudhën që nga krijimi i forcës politike komuniste antifashiste. Sipas nismëtarëve, bazuar në dokumente historike, lufta Antifashiste Nacional-Çlirimtare arriti objektivat themelore dhe konkretisht çlirimin e vendit dhe rivendosjen e pavarësisë kombëtare. Rregjimi komunist nuk mund të lidhet me periudhën e luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare (në vijim “LANÇ”), luftë e cila u fitua me gjakun e mijëra dëshmorëve dhe siguroi pavarësinë e vendit. Vetëm pas përfundimit të LANÇ, Fronti Demokratik, ku ishin të përfshirë komunistët mori në dorë qeverisjen e vendit duke vendosur disa detyra, ndërmjet të cilave: eliminimi i kundërshtarëve politikë, qeverisja e re, hartimi i Kushtetutës, reforma ekonomike etj. Si rrjedhojë, periudha e komunizmit, objekt i këtij ligji, nuk mund të jetë periudha para datës 28 nëntor 1944, ndaj sugjerohet që të hiqet togfjalëshi *“periudha përpara datës 29 nëntor 1944, gjatë së cilës është zhvilluar veprimtaria, që ka përgatitur ardhjen në pushtet të Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila, më pas, u shndërrua në Partia e Punës e Shqipërisë”*.

Z. Shameti gjithashtu prezantoi ndryshimin tjetër të parashikuar në këtë projektligj, nëpërmjet të cilit synohet rritja e besueshmërisë së nëpunësve dhe punonjësve të Institutit, duke parashikuar detyrimin ligjor për t’u pajisur me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, për plotësimin e kushteve për njohjen,

ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

Z. Shameti argumentoi se informacioni i grumbulluar, administruar e ruajtur në arkivin e Institutit, të dokumenteve e të materialeve, që dëshmojnë krimet e komunizmit në Shqipëri, lidhet me burime konfidenciale dhe duhet t'i nënshtrohet procesit të klasifikimit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 6 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror".

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Nga relatorja u vlerësua ndërmarrja e kësaj nisme ligjore, e cila vjen në zbatim të rezolutës së miratuar nga Kuvendi "Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2018".

Saktësimi i periudhës së komunizmit nëpërmjet ndryshimit të propozuar në projektligj, vjen në harmoni me dispozitat e tjera të ligjit në fuqi nr. 10242, datë 25.2.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri". Kështu, në gjurmën "b" dhe "c", të nenit 3 të ligjit përcaktohet se:

"Krimet e komunizmit" janë veprimet e kryera nga funksionarët e shtetit komunist në periudhën e komunizmit, të cilat kanë të bëjnë me konceptimin, përpunimin apo vënien në zbatim të masave represive, të shoqëruara me shkelje të tjera të të drejtave të njeriut ose me akte që përbëjnë gjenocid, krime kundër njerëzimit, si dhe krime kundër jetës dhe shëndetit të individit, në kuptim të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe të legjislacionit penal.

"Funksionar i sistemit komunist" është funksionari publik ose personi që gëzonte mbrojtje të barabartë me atë të funksionarit publik, ku përfshihen, në mënyrë të veçantë, funksionarët shtetërorë dhe funksionarët e lartë partiakë.

Në kuptim të sa më sipër, periudha para vitit 1944 nuk mund të jetë objekt i studimit të Institutit, pasi kjo periudhë nuk përkon me krijimin e shtetit shqiptar komunist, apo me ekzistencën e funksionarëve të shtetit komunist.

Diskutimet dhe debatet në komision u përqëndruan veçanërisht në ndryshimin që parashikon neni 2 i këtij projektligji, për paisjen e punonjësve të Institutit me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, për plotësimin e kushteve për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

Anëtarët e komisionit kërkuan informacion nga drejtori i Institutit, z. Agron Tufa, lidhur me dokumentet dhe materialet që grumbullohen, administrohen e ruhen në arkivin e Institutit si dhe rastet e njohjes me informacione dhe materiale të klasifikuara "sekret shtetëror", sipas përcaktimeve të bëra në nenin 6 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror".

Nga informacioni i dhënë nga drejtori i Institutit, nuk ka patur raste të njohjes me informacione dhe materiale të klasifikuara “sekret shtetëror”.

Në këtë aspekt Komisioni, pas diskutimeve, bazuar edhe në propozimin e z. Manja, z. Lita, z. Fino, vlerëson si të panevojshëm ndryshimin e propozuar nga neni 2 i projektligjit.

IV. NDRYSHIME TË MIRATUARA NË KOMISION

- **Neni 2** të hiqet.
- Dispozita e hyrjes në fuqi të numërtohet.

V. PËRFUNDIME

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- a) *Në aspektin ligjor*, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) *Në aspektin procedural*, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të komisionit e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORE

KRYETARI

KLOTÏLDA BUSHKA (FERHATÏ)

ULSI MANJA